



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:097164

Datë: 05.03.2025 Numri i  
06944783 dokumentit:

Ac.nr.863122

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka kryetare e kolegjit, Nora Bllaca-Dula dhe Naime Ahmeti, anëtare, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.D nga Ferizaj, rruga “A.M”, ndërtesa \*\*\*, banesa nr.\*, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Anton Ndrecaj, jurist, nga Qendra për Ndihmë Juridike në Prishtinë, kundër të paditurit T.H, B.R dhe J.R nga fshati G., Komuna e Ferizajt, të cilët sipas autorizimi i përfaqëson Kemajl Ademaj, avokat nga Ferizaj dhe të paditurës Komuna e Ferizajt, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sami Vranovci, jurist, për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, C.nr.2022:\*\*\*\*\* të datës 14.11.2022, i korrigjuar me Aktvendimin e dt. 12.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.02.2025, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. REFUZOHET pjesërisht e pabazuar ankesa e paditësit A.D nga Ferizaj, rruga “A.M”, ndërtesa kolektive 215, banesa nr. 8, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, C.nr.2022:\*\*\*\*\* të datës 14.11.2022, i korrigjuar me Aktvendimin e dt.

12.12.2022 pjesërisht përkitazi me shpenzimet e procedurës kontestimore dhe ate: për përfaqësim nga ana e avokatit në 7 (shtatë) seanca të mbajtura gjyqësore shumë prej 1,890.00 Euro (7 x 270 Euro), për 1 (një) seancë të shtyer gjyqësore në shumë prej 135 Euro dhe në emër të taksës gjyqësore për sigurimin e shkresave të lëndës C.nr.\*\*\*/15 nga arkivi i gjykatës shumë prej 20 Euro, e në shumë totale prej 2,045.00 Euro, VËRTETOHET.

II.APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e paditësit A.D nga Ferizaj, rruga "A.M", ndërtesa kolektive 215, banesa nr. 8, NDRYSHOHET Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, C.nr.2022:\*\*\*\*\* të datës 14.11.2022, i korrigjuar me Aktvendimin e dt.

12.12.2022, ashtu që gjykohet si në vijim:

*Refzuohet e pabazuar* kërkesa e të paditurve T.H, B.R dhe J.R nga fshati G., Komuna e Ferizajt, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet paditësi A.D nga Ferizaj që t'ua paguaj të paditurve në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore: për shqyrtimin e shkresave të lëndës shumë prej 104.00 Euro, për konsultimin me të paditurit shumë prej 104.00 Euro dhe për përgjigje në ankesën e ushtruar nga paditësi shumë prej 208 Euro.

## A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar C.nr.2022:\*\*\*\*\* të datës 14.11.2022, i korrigjuar me Aktvendimin e dt.12.12.2022 e ka aprovuar si të bazuar kërkesën e të autorizuarit të paditurve T.H, B.R dhe J.R nga fshati G., Komuna e Ferizajt, avokatit Kemajl Ademaj nga Ferizaj lidhur me shpenzime të procedurës dhe e ka detyruar paditësin A.D nga Ferizaj, rruga "A.M", ndërtesa kolektive 215, banesa nr. \*, që të paditurve në emër të shpenzimeve të procedurës t'ua paguaj shumë prej 2,357.00 €, në mënyrë solidare, në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktvendimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë paditësi duke e atakuar të njëjtin për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktvendimi i ankimuar të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesën e paditësit kanë paraqitur të paditurit nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, me të cilën i kanë kundërshtuar pretendimet ankimore të paditësit, me propozim për Gjykatën e Apelit që të refuzohet ankesa e paraqitur nga paditësi dhe të vërtetohet aktvendimi i atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me dt.18.01.2016, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi kundër të paditurve për kompensimin e dëmit material, me kërkesë dhe arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin C.nr. \*\*/16 të dt. 22.03.2022 e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit të ushtruar kundër të paditurve dhe e ka obliguar paditësin që të paditurve t'ua kompensoj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1,952.00 Euro.

Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë duke vepruar sipas ankesës së paditësit me Aktvendimin Ac.nr.\*\*\*\*/22 të dt. 19.07.2022 e ka vërtetuar aktvendimin e sipërcituar të gjykatës së shkallës së parë në pikën I me të cilën padia e paditësit është konsideruar e tërhequr dhe e ka anuluar aktvendimin në pikën II përkitazi me shpenzimet e procedurës dhe për këtë pjesë çështjen e ka kthyer në rivendosje.

Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë pas mbajtjes së seancës gjyqësore dhe precizimit të shpenzimeve të procedurës nga ana e të paditurve nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, ka marr aktvendimin e ankimuar C.nr.2022:\*\*\*\*\* të datës 14.11.2022, i korrigjuar me Aktvendimin e dt. 12.12.2022, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesën e të paditurve për shpenzime të procedurës dhe e ka detyruar paditësin që të paditurve në emër të shpenzimeve të procedurës t'ua paguaj shumën prej 2,357.00 €, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit.

Për mënyrën e vendosjes si në aktvendimin e ankimuar gjykata i është referuar dispozitës së nenit 449 dhe 452 të LPK-së, me arsyetimin se shpenzimet gjyqësore

të kërkuara nga të paditurit e të precizuara me specifikacionin e dt. 14.11.2022, janë të bazuara dhe si të tilla i ka aprovuar.

Gjykata e Apelit duke i pasur për bazë pretendimet ankimore të paditësit vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht i ka zbatuar dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore me rastin e vendosjes, konkretisht dispozitën e nenit 453.1 të LPKsë, andaj kjo gjykatë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 194 lidhur me nenin 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (c) e LPK-së, aktvendimin e ankimuar e ka ndryshuar duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së shprehimisht parashihet se: *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqfituese dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*.

Me dispozitën e nenit 453.1 të LPK shprehimisht parashihet se: *„ Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat “*.

Me dispozitën e nenit 463.1 të LPK-së parashihet se: *“Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën”,* ndërsa me par. 2 të kësaj dispozite parashihet se: *“ Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës”*.

Nga interpretimi i dispozitave të sipërcituara ligjore e nga rrethanat konkrete të çështjes rezulton se në rastin konkret pala paditëse ka për detyrë që palës së paditur e cila shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, t’ia kompensoj ato shpenzimet procedurale të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e kësaj çështjeje në gjyq dhe për të cilat pala ka ofruar prova, andaj Gjykata e Apelit e Kosovës me pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktvendimi e ka vërtetuar aktvendimin e ankimuar përkritazi me shpenzimet e procedurës kontestimore të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë dhe ate: për përfaqësim nga ana e avokatit në 7 (shtatë) seanca të mbajtura gjyqësore shumë prej 1,890.00 Euro (7 x 270 Euro), për 1 (një) seancë të shtyer gjyqësore në shumë prej 135 Euro dhe në emër të taksës gjyqësore për

sigurimin e shkresave të lëndës C.nr.\*\*\*/15 nga arkivi i gjykatës shumën prej 20 Euro, e në shumën totale prej 2,045.00 Euro, ndërsa me pikën II (dy) të dispozitivit të këtij aktvendimi (Aktvendimi i Gjykatës së Apelit) e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesës për shpenzime të procedurës dhe ate për shqyrtimin e shkresave të lëndës dhe për konsultimin me të paditurit nga 104,00 Euro, duke u bazuar në Rregulloret për Tarifën e Avokatëve me të cilat është përcaktuar tarifa për shërbimet e avokatëve dhe në mungesë të provave për shpenzimet e kërkuara nga të paditurit, ndërsa kërkesën për shpenzime të procedurës për përgjigje në ankesë, gjykata e Apelit e ka refuzuar pasi kjo parashtrësë nuk ka qenë me ndikim në vendosjen sipas ankesës dhe në kuptim të nenit 453.1 të LPK-së, nuk pranohet si shpenzim i domosdoshëm për ndjekjen e çështjes në gjykatë.

Nga të cekurat më lart, e në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (c) e LPK-së, u vendos si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
Ac.nr.8631/22 të dt.28.02.2025

Kryetarja e kolegjit

Halide Reka, d.v

Numri i lëndës: 2019:097164  
Datë: 05.03.2025  
Numri i dokumentit: 06944783